



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI**

Bulevardi "Bajram Curri", Nr.1 Tiranë, Shqipëri- Tel/Faks. +355 4 362937 - www.moh.gov.al

Nr. 2542 Prot.

Tiranë, më 12/07/2011

URDHËR

Nr. 287 datë 12.07.2011

**PËR
PAJISJEN ME VULË TË BARNAVE QË PËRDOREN NË INSTITUCIONET
SHËNDETËSORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

URDHËROJ

1. Barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor publik përveç pullës së sigurisë duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin "Përdorim Spitalor – Ndalohet shitja".
2. Në sistemin shëndetësor publik lejohet të qarkullojnë barna që mbajnë pullë sigurie me çmim për rrjetin e hapur farmaceutik vetëm nëse ato mbajnë vulën me mbishkrimin "Përdorim Spitalor – Ndalohet shitja".
3. Forma, përmasat dhe shkronjat brenda vulës duhet të jenë sipas përcaktimeve të bëra në aneksin bashkëngjitur këtij urdhëri.
4. Boja që përdoret për stampimin e vulës të jetë me ngjyrë të kuqe që nuk fshihet.
5. Ngarkohet Drejtoria Spitalore në Ministrinë e Shëndetësisë, Drejtoria Farmaceutike dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 25.07.2011.


MINISTRI

PETRIT VASILI



Aneksi 1.

← 40 mm →



Gjatesia : 40 mm
Gjeresia : 15 mm
Font : arial narrow
Font size : 11
Font color : red
Font style : bold